
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	Zyra e Personelit Kancelarija za Osoblje		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.02/19	Datë: 09.01.2019	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall :

## KONKURS

### Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Vendi i punës :** Anketues

**Drejtoria:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa

**Lloji i pozitës:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, kohëzgjatja 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

**Numri i referencës:** 02Nr.02/19

**Numri i ekzekutuesve:** 2 (dy)

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Paga:** 350 euro

#### Detyrat dhe përgjegjësit:

- Viziton objektet në teren, identifikon pronarin e pronave dhe regjistron pronarin apo shfrytëzuesin e pronës, bënë klasifikimin e pronës, matjen e pronës, fotografimin e pronës dhe përshkruan të dhënat tjera si vendbanimi, rruga, nr.i objektit etj dhe i bartë të gjitha shënimet online në Sistemin e TP të instaluar në në Tablet. Zbaton Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Udhëzimet e MF;
- Viziton Objektet në teren që kanë pësuar ndryshime me qëllim të verifikimit dhe bënë korrigjimin e gjendjes paraprake duke i bartur shënimet e reja dhe gjendjen faktike në Sistemin e TP online në Tablet;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, identifikon dhe regjistron referencat dhe koordinatat korrekte kadastrale të pronave të caktuara;
- Bënë azhurnimin e dosjeve , freskomin me të dhënat e reja për tatimpaguesit;
- Kryen modifikimin e emrave të tatimpaguesve dhe mbanë dosje fizike për secilin rast;
- Gjen personat të cilëve ju kan adresuar faturat tatimore, vërejtjet tjera, Vendimet e Bordit Komunal të Ankesave dhe merr nënshkrimet e marrësit të faturës, vërejtjet dhe vendimet;
- Kryen edhe punë të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Dokumentet:**

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: diploma e Fakultetit Ekonomik .
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

**Afati i Konkurrimit:** Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit, procedur e shpejtuar.

Data e shpalljes së konkursit: 09.01.2019 deri më 16.01.2019

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen

**Menaxheri i Personelit  
Fatmir Bytyçi**

